Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 10 qershor 2011

Lënda nr. 13/08

Gani THAÇI

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 10 qershor 2011, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Paul LEMMENS, kryesues
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
Znj. Anila PREMTI, ushtruese e detyrës së Zyrtares ekzekutive

Pasi regjistroi tërheqjen e z. Marek Nowicki nga shqyrtimi i lëndës, në pajtim me rregullën 12 të Rregullores së punës.

Pasi shqyrtoi ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në përputhje me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006.

Pas diskutimit vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 2 qershor 2008 dhe është regjistruar në të njëjtën datë. Më 17 qershor 2008, ankuesi më tej elaborojë ankesën e tij.

2. Përmes letrës së datës 6 tetor 2008, Paneli kërkoi informata sqaruese nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). PSSP-ja iu përgjigj Panelit përmes letrës së datës 12 dhjetor 2008, duke cekur se ai nuk ishte në posedim të dosjes për procedurën disiplinore të ankuesit. Pas kërkesës tjetër të Panelit, të datës 27 janar 2010, PSSP-ja u përgjigj më 1 shkurt 2010, duke thënë se ende nuk e kishte marrë këtë dosje.

3. Paneli kërkoi informatat të tjera nga PSSP-ja më 4 shkurt 2010. PSSP-ja u përgjigj më 19 maj 2010 që në atë moment nuk ishte në gjendje të ofrojë informatën e kërkuar. Më 2 gusht është marrë ajo informatë.

4. Më 9 shtator 2010, Paneli shpalli të papranueshme pjesën e ankesës. Gjithashtu vendosi të shtyjë shqyrtimin e pjesës së mbetur të ankesës.

5. Më 29 shtator 2010, Paneli ia komunikoi PSSP-së pjesën e mbetur të ankesës në mënyrë që të merr komentet e UNMIK-ut për pranueshmërinë e saj. Paneli prapë kërkoi nga PSSP-ja që t'ia jep dosjen e procedurës disiplinore të ankuesit.

6. Më 2 dhjetor 2010, PSSP-ja informoi Panelin që janë bërë përpjekje për marrjen e dosjes disiplinore në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto rrethana, PSSP-ja nuk kishte komente për pranueshmërinë e ankesës, por rezervoi të drejtën e tij për të dhënë komente në një fazë të mëvonshme.

7. Më 6 janar 2011, Paneli mori informata të tjera nga ankuesi, të cilat ia komunikoi PSSP-së më 17 shkurt 2011.

8. Më 21 mars 2011, PSSP-ja dha komentet e veta për pranueshmërinë e ankesës. Në komente thuhet se UNMIK-u nuk ka mundur të merr tërë dosjen disiplinore të ankuesit.

II. FAKTET

9. Faktet relevante për këtë fazë të procedurës mund të përmblidhen si në vijim:

A. Procedurat disiplinore të vitit 2001

10. Në tetor të vitit 1999, ankuesi është emëruar si komandant i Komandës së strehimit në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK).

11. Në vitin 2000, ai është degraduar në një pozitë më të ulët. Ai ngriti procedurë kundër këtij vendimi para gjykatave, por padia e tij është refuzuar. Përpjekjet e tjera që të kthehet në pozitën e vet të mëparshme (apo më të lartë) gjithashtu kanë dështuar.

12. Më 1 gusht 2001, komandanti i TMK-së (gjenerallejtënant Çeku) ka suspenduar ankuesin, në mes të tjerash, për arsye se në korrik të vitit 2001 ai kishte dhënë deklarata të paautorizuara për TMK-në apo në emër të saj. Suspendimi do të mbetej në fuqi deri në përfundimin e procedurave disiplinore, të nisura kundër ankuesit në bazë të fakteve të njëjta. Në vendim thuhej se miratimi ishte marrë nga Komiteti i Përbashkët Ekzekutiv për Siguri (JSEC). Asokohe, JSEC-ja ishte organi më lartë për bashkërendimin e çështjeve të sigurisë mes UNMIK-ut dhe KFOR-it, si dhe organ kompetent disiplinor në rast të veprave penale dhe veprave të tjera të rënda të mospërputhjes me Kodin disiplinor të TMK-së. Më 13 gusht 2001, ankuesi u ankua kundër suspendimit të tij tek Bordi strategjik i TMK-së. Sipas ankuesit, ende nuk është marrë kurrfarë vendimi për atë ankesë.

13. Në tetor të vitit 2001, ankuesit i është dhënë kopja e njoftimit të Koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në, që i drejtohej komandantit të TMK-së dhe që mbante datën 10 gusht 2001, ku thuhej se ky i fundit duhet të shkarkojë një numër pjesëtarësh të TMK-së, duke përfshirë edhe ankuesin, "në bazë të kështillës së JSEC-së, të datës 8 gusht 2001. Më vonë doli se në fakt JSEC-ja kishte marrë vendimin për të shkarkuar pjesëtarët e TMK-së. Duket se ankuesi asnjëherë nuk kishte marrë kopjen e një vendimi të tillë. Për më tepër, vendimi fare nuk ishte miratuar nga PSSP-ja, që ishte i vetmi autoritet kompetent për shkarkimin e pjesëtarëve të TMK-së (shih nenin 2.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/8, të datës 20 shtator 1999 për themelimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës).

14. Sipas ankuesit, ai nuk ka marrë pagë nga TMK-ja pas 1 korrikut 2001.

B. Procedura disiplinore e vitit 2005

15. Më 28 janar 2005, koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në (gjeneralmajori Freer) informoi komandantin e TMK-së (gjenerallejtënant Çekun) dhe Inspektoratin e KFOR-it për çështje të TMK-së se shkarkimi i ankuesit nuk ishte në përputhje me procedurën e paraparë në Kodin disiplinor të TMK-së të vitit 2001, që atëherë ishte në fuqi, dhe se lënda disiplinore duhet të rishqyrtohet. Koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në gjithashtu informoi ankuesin se për shkak të parregullsive procedurale, vendimi për shkarkimin e tij asnjëherë nuk ishte miratuar nga PSSP-ja dhe se rrjedhimisht, lënda do të duhet të rishqyrtohet nga JSEC-ja.

16. Më 10 shkurt 2005, Zyra ligjore e TMK-së dërgoi një letër që përmbante akuzat kundër kolonel Cikaçit, që asokohe ishte zëvendëskomandant i Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së. Ankuesi mori këtë informatë më 16 shkurt 2005. Më 17 shkurt 2005 ai ia parashtroi një deklaratë Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, që përmbante komentet për akuzat e ngritura ndaj tij. Kjo deklaratë është dashur të dërgohet JSEC-së. Është e paqartë nëse kjo deklaratë në fakt ka mbërri në vendin e duhur. Në bazë të ankuesit, ajo nuk ka mbërri në vendin e duhur.

17. Në prill të vitit 2005, JSEC-ja rekomandoi shkarkimin e ankuesit (raporti nr. 685/05). Në bazë të të njëjtave deklarata të bëra nga ankuesi, JSEC-ja gjithashtu rekomandoi se ai nuk duhet të merr pagesë, duke marrë parasysh faktin se ankuesi është suspenduar që nga 1 gushti 2001 dhe ky suspendim ka mbetur në fuqi. Megjithatë, duke marrë për bazë kohëzgjatjen e procedurës dhe faktin se lënda nuk

është trajtuar me vëmendjen e duhur, JSEC-ja ka rekomanduar që ankuesi të merr pagesë të barabartë me pagën mujore të tetarit në TMK. Panelit nuk i është dhënë kopja e këtij rekomandimi. Dokumentet e parashtruara nga ankuesi dhe informata e dhënë nga PSSP-ja nuk ia mundësojnë Panelit që të përcaktojë kur dhe si është informuar ankuesi për këtë rekomandim.

18. Pohohet se PSSP-ja ishte pajtuar me rekomandimin e JSEC-së më 5 korrik 2005. Panelit nuk i është dhënë kopja e atij vendimi, por PSSP-ja nuk e vë në pyetje faktin se ai vendim është marrë. Në pajtim me këtë vendim, ankuesi është shkarkuar nga TMK-ja. Nuk është e qartë nëse ankuesi ka marrë ndonjë pagesë, ashtu siç a rekomanduar JSEC-ja.

19. Sipas ankuesit, ai ka parashtruar një "ankesë" kundër këtij vendimi më 15 korrik 2005. Si dokument përcjellës i ankesës është paraqitur letra prej 11 faq esh. Në mes të tjerash, ankuesi argumentoi se është konsideruar si i suspenduar për katër vjet, ndërsa suspendimi më së shumti mund të zgjasë gjashtë muaj. Ankesa i është dërguar kolonel Cikaçit, në kapacitetin e tij të zëvendëskomandantit të Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, me kërkesë që përmes Shtabit të përgjithshëm të TMK-së ta përcjellë ankesën tek JSEC-ja.

20. Ndaj kësaj ankese nuk ka pasur reagim. Pasi që ankuesi u interesua për gjendjen e procedurës, ish-Koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në (gjeneralmajori Steirn) ia dërgoi një letër më 14 mars 2006, ku thuhet si në vijim:

> "I referohem letrës së paraardhësit tim, të datës 1 nëntor 2005, dhe letrës së zyrtarit tim ligjor, të datës 19 janar 2006.
>
> Siç është cekur më herët, ankesa e juaj për raportin e JSEC-së 685/05 nuk është pranuar nga Zyra ime, TMK-ja apo nga [Inspektorati i KFOR-it për çështje të TMK-së]. Në bazë të Kodit disiplinor, ankesat duhet të bëhen përmes [komandantit të TMK-së] brenda 21 ditësh. Nga ju është kërkuar që ta ridërgoni ankesën tuaj përmes kanaleve të duhura dhe që të jepni vërtetimin postar për dërgimin e mëparshëm të ankesës, gjë e cila nuk është bërë. Edhe pse keni dërguar vërtetimin postar për një numër letrash, ju nuk keni dorëzuar vërtetimin postar për letrën e datës 18 (*sic*) korrik 2005, ku gjendet ankesa e juaj.
>
> Pasi që ankesa juaj nuk është pranuar nga [komandanti i TMK-së] ose nga cilado prej zyrave relevante, dhe ju nuk mund ta vërtetoni se e keni dërguar brenda afatit 21 ditor për parashtrimin e ankesës, me keqardhje ju informoj se kjo lëndë tani është e mbyllur."

21. Më 10 prill 2006, ankuesi ia dërgoi një letër kolonel Cikaçit, duke kërkuar nga ai shpjegim për atë se çka kishte bërë me ankesën e ankuesit, të dërguar më 15 korrik 2005. Paneli nuk është në dijeni për ndonjë reagim ndaj asaj letre.

22. Më 13 korrik 2006, ankuesi është pranuar nga komandanti i TMK-së (gjenerallejtënant Selimi). Me këtë rast ai dorëzoi një letër, ku ankohej për faktin se kolonel Cikaçi nuk i kishte përcjellë në vendin e duhur deklaratën e tij të datës 17

shkurt 2005 dhe ankesën e 15 korrikut 2005. Ai kërkoi shqyrtimin e ankesës së tij. Duket se nuk është ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me këtë letër.

C. Kontesti administrativ lidhur me mosveprimin e pretenduar të JSEC-së dhe TMK-së

23. Në ndërkohë, më 29 qershor 2006, ankuesi ka filluar një kontest administrativ në Gjykatën Supreme kundër mosveprimit të JSEC-së dhe të Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së.

24. Më 14 maj 2008, Gjykata Supreme shpalli ankesën si të papranueshme. Arsyet për këtë vendim janë si në vijim:

> "Në nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, të datës 15 maj 2001, parashihet që Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) janë organizatë civile për emergjenca, e themeluar në bazë të ligjit, e cila në Kosovë kryen detyra të reagimit të shpejtë ndaj katastrofave për qëllime të sigurisë publike, në kohëra të emergjencave dhe të ndihmës humanitare. Përmes dispozitave të nenin 8.1, pika k, të Rregullores së lartpërmendur parashihet që TMK-ja vepron nën kontrollin dhe pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP).
>
> Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/8 për themelimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës parasheh që trupat e Mbrojtjes së Kosovës të veprojnë nën pushtetin e PSSP-së.
>
> Neni 30, paragrafi 1, pika 5 e Ligjit për konteste administrative parasheh që asnjë kontest administrativ nuk mund të fillohet lidhur me çështjet, për të cilat mundësia e fillimit të një kontesti administrativ është e përjashtuar përmes një dispozite eksplicite ligjore.
>
> Për shkak të faktit se neni 3.2 (*sic*) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre parasheh që punonjësit e KFOR-it janë imun nga juridiksioni i gjykatave të Kosovës lidhur me çfarëdo vepre administrative, civile apo penale, të kryer nga ata në territorin e Kosovës, nuk mund të fillohet kurrfarë kontesti administrativ kundër Komitetit të përbashkët ekzekutiv për siguri në kuadër të Shtabit të përgjithshëm të KFOR-it, me seli në Prishtinë, dhe kundër Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, me seli në Prishtinë.
>
> Për shkak të arsyeve të cekura më lartë dhe në pajtim me nenin 30, paragrafi 2 i [Ligjit për procedurën kontestimore], Gjykata vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi."

25. Më 24 qershor 2008, ankuesi parashtroi padi penale kundër gjykatësit të Gjykatës Supreme, i cili kryesoi kolegjin që nxori vendimin e datës 14 maj 2008. Paneli nuk është informuar për çfarëdo zhvillime të tjera lidhur me atë ankesë.

D. Padia penale kundër kolonel Cikaçit

26. Në ndërkohë, më 4 korrik 2006, ankuesi kishte ngritur padi private kundër kolonel Cikaçit në Gjykatën komunale të Prizrenit. Ai ankohej se kolonel Cikaçi nuk e kishte përcjellë deklaratën e tij, të datës 17 shkurt 2005, kundër vendimit të PSSP-së, të datës 5 korrik 2005.

27. Duket se Gjykata komunale në Prizren ka nxjerrë dy aktgjykime për këtë lëndë. Në aktgjykimin e parë, të datës 11 shtator 2006, Gjykata shpalli akuzat si të papranueshme, pasi që kanë qenë të parashtruara më shumë se tre muaj pasi që ankuesi ka qenë në dijeni për ekzistimin e veprave të pretenduara penale. Duket se më vonë lënda është rihapur. Sidoqoftë, në aktgjykimin e dytë, të nxjerrë më 18 shtator 2008, pas seancës dëgjimore ku si ankuesi, ashtu edhe kolonel Cikaçi ishin paraqitur, Gjykata regjistroi deklaratën e këtij të fundit, ku thuhej se ai nuk ka pranuar asgjë që duhet të përcillej në Zyrën ligjore të TMK-së, e cila më pastaj do ta përcillte në vendin e duhur. Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar se i padituri kishte pranuar deklaratën apo ankesën e ankuesit. Rrjedhimisht, Gjykata shpalli të paditurin të pafajshëm. Ky aktgjykim i fundit i është dërguar djalit të ankuesit, më 4 nëntor 2008, pasi ankuesi atëbotë jetonte jashtë.

28. Më 12 nëntor 2008, ankuesi u ankua kundër aktgjykimit. Përmes aktgjykimit të datës 17 dhjetor 2008, Gjykata e qarkut në Prizren shpalli ankesën si të papranueshme, pasi që ishte parashtruar jashtë afatit. Duket se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës së qarkut.

III. ANKESA

29. Ankuesi ankohet për faktin se komentet e tij për akuzat disiplinore, të ngritura kundër tij në vitin 2005, JSEC-ja nuk i ka shqyrtuar në mënyrë të efektshme, para se i njëjti organ të merrte vendimin për të rekomanduar shkarkimin e tij.

30. Ai më tej ankohet për faktin se ankesa e tij kundër vendimit të PSSP-së për të miratuar rekomandimin e JSEC-së (pretendohet se vendimi është marrë më 5 korrik 2005), në fakt asnjëherë nuk është shqyrtuar nga organi ku ai ka parashtruar ankesën, gjegjësisht nga JSEC-ja. Ai argumenton se kjo ka ndodhur për shkak të faktit se Cikaçi, zëvendëskomandant i Zonës së dytë mbrojtëse, të cilit ankuesi ia ka dërguar ankesën e tij më 15 korrik 2005, nuk ia ka përcjellë këtë ankesë organit kompetent.

31. Ai më tej ankohet për aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të datës 14 maj 2008, përmes të cilit kontesti administrativ i ngritur nga ai shpallet i papranueshëm. Ky kontest kishte të bënte me mosveprimin e JSEC-së dhe të TMK-së ndaj ankesës së tij kundër vendimit të PSSP-së, të datës 5 korrik 2005.

32. Ankesa e parë mund të shqyrtohet nga pikëpamja e së drejtës në qasje në shërbime publike, e garantuar përmes nenit 25 (c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (KNDCP), ndërsa ankesa e dytë dhe e tretë mund të shqyrtohet nga pikëpamja e së drejtës për mjet të efektshëm ligjor kundër shkeljeve të

pretenduara të të drejtave të njeriut (neni 2 (3) i KNDCP-së, në lidhje me nenin 25 (c) të KNDCP-së (shih vendimin e Panelit, të datës 9 shtator 2010, § 36).

IV. LIGJI

33. Para se lënda të shqyrtohet për bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendos nëse duhet të pranojë lëndën apo jo, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të parapara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006.

34. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli mund të trajtojë çështjen e caktuar vetëm pasi të ketë përcaktuar që e njëjta është parashtruar "brenda periudhës gjashtëmujore nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar".

35. PSSP-ja argumenton se ankesa është parashtruar jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh. Ai cek se supozohet se PSSP-ja ka miratuar rekomandimin për shkarkimin e ankuesit më datën 5 korrik 2005. Më 14 mars 2006, ankuesi është informuar nga Koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në që ankesa e tij kundër vendimit të PSSP-së asnjëherë nuk është pranuar nga JSEC-ja dhe nuk ka mundur të gjendet në asnjërën prej dosjeve. Ky njoftim i Koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në mund të konsiderohet si dita e njoftimit përfundimtar për shkarkimin e ankuesit nga TMK-ja. Ankesa është parashtruar në Panel tek më 2 qershor 2008. Në atë datë, është qartë se afati gjashtëmujor për parashtrimin e ankesës në Panel kishte kaluar.

36. Me tej PSSP-ja argumenton se vendimi përfundimtar i Gjykatës së qarkut të Prizrenit, i datës 17 dhjetor 2008, lidhur me padinë penale të ngritur nga ankuesi kundër ish-kolonelit të TMK-së për pretendimin se nuk është përcjellë ankesa e tij tek autoritetet relevante, nuk është relevant për periudhën gjashtëmujore, pasi që këto procedura lidhem me procedurat penale mes dy individëve privatë dhe nuk përfshijnë UNMIK-un.

37. Afati gjashtëmujor, i paraparë në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, parasheh që ankuesit të parashtrojnë ankesa brenda gjashtë muajsh nga marrja e vendimit përfundimtar gjatë procesit të shterjes së mjeteve juridike në dispozicion. Për qëllime të përllogaritjes së periudhës gjashtëmujore, vetëm mjetet e rregullta dhe të efektshme ligjore mund të merren parasysh, pasi që ankuesi nuk mund të shtyjë afatin strikt kohor, të përcaktuar sipas Rregullores, duke tentuar të bëjë parashtrime jo të duhura apo të keqkuptuara tek organet ose institucionet, të cilat nuk kanë pushtet apo kompetencë për të ofruar zgjidhje të efektshme të ankesës në fjalë sipas Rregullores (shih lidhur me afatin gjashtëmujor, të paraparë në nenin 35 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj): Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, vendimi i datës 5 janar 2006; GjEDNj, *Svenska Flygföretagens Riksförbund dhe Skyways Express AB kundër Suedisë*, nr. 32535/02, vendim i datës 12 dhjetor 2006; GJEDNj, *Sobczynski kundër Polonisë*, numrat. 355/04 dhe 358/04, vendim i datës 25 shtator 2007; GjEDNj, *Hysi kundër Shqipërisë*, nr. 38349/05, vendim i datës 26 shkurt 2008).

38. Paneli vëren se PSSP-ja pranon se, për qëllime të shqyrtimit të pranueshmërisë së kësaj ankese, letra e Koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në, e datës 14 mars 2006, përmes së cilës informohej ankuesi se ankesa e tij nuk është pranuar dhe se lënda ishte "mbyllur", mund të konsiderohet si dita e njoftimit përfundimtar për vendimin që pohohet të jetë nxjerrë më 5 korrik 2005, përmes të cilit ankuesi shkarkohej nga TMK-ja.

39. Pas pranimit të njoftimit, ankuesi filloi kontestin administrativ në Gjykatën Supreme kundër dështimit të pretenduar të JSEC-së dhe të TMK-së për të ndërmarrë veprime ndaj ankesës kundër vendimit për shkarkimin e tij. Një kontest i tilli administrativ, i nisur në Gjykatën Supreme është mjet juridik, përmes të cilit mund të ofrohet zgjidhje e efektshme, pasi që një kontest administrativ mund të parashtrohet në gjykatën supreme ndaj dështimit të autoritetit administrativ në marrjen e vendimit për një ankesë të caktuar (neni 26 i Ligjit për konteste administrative).

40. Është e vërtetë se juridiksioni i Gjykatës Supreme mund të përjashtohet përmes ligjit (neni 30, paragrafi 1, pika 5 e Ligjit për konteste administrative). Për lëndën në fjalë, Gjykata Supreme konstatoi se juridiksioni i saj ishte përjashtuar për shkak të imunitetit që i është dhënë punonjësve të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Derisa Gjykata Supreme iu ka referuar vetëm nenit 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, është e qartë nga konteksti i arsyetimit përkatës se në fakt është mbështetur në nenin 2.4 dhe 3.2 të Rregullores në fjalë, përmes të cilëve garantohet imuniteti para gjykatave në Kosovë për punonjësit e KFOR-it dhe PSSP-në, zëvendësin kryesor të PSSP-së dhe zëvendësin e PSSP-së, komisionarin e policisë dhe zyrtarët e tjerë të lartë, ashtu siç PSSP-ja mund të vendos. Mungesa e juridiksionit e Gjykatës Supreme duhet që normalisht të çojë në përfundim se padia në Gjykatën Supreme nuk ka qenë mjet juridik, dhe se rrjedhimisht nuk është marrë parasysh për qëllime të përllogaritjes së periudhës gjashtëmujore.

41. Megjithatë, Paneli konstaton se vet mungesa e juridiksionit e Gjykatës Supreme është subjekt i njërës prej ankesave. Konstatimi i Panelit se Gjykata Supreme, duke shpallur vetën si pa juridiksion, ka shkelur të drejtat e njeriut të ankuesit, do të nënkuptonte se mungesa e juridiksionit nuk ka qenë arsye e vlefshme kundër ankuesit për t'ia mohuar atij qasjen në Gjykatën Supreme. Në këto rrethana gjithashtu nuk do të kishte qenë e mundur se për qëllime të përllogaritjes së periudhës gjashtëmujore, kontesti administrativ në Gjykatën Supreme ishte mjet juridik i gjykuar për dështim. Si rezultat i kësaj, vendimi i Gjykatës Supreme, përmes së cilit kërkesa e ankuesit shpallet e papranueshme do të duhej të konsiderohet si vendim i formës së prerë (krahaso GjEDNj, *Remli kundër Francës,* aktgjykimi i datës 23 prill 1996, *Raporte për aktgjykime dhe vendime*, 1996-II, f. 572, § 42). Ankesa e parashtruar në Panel më 2 qershor 2008, ishte kundër dështimit të Gjykatës Supreme për të vepruar në bazë të kërkesës së tij, të datës 17 maj 2008, dhe do të duhej të konsiderohet se është parashtruar brenda afatit gjashtëmujor. Duhet të theksohet se paditë pasuese private, të ngritura nga ankuesi kundër kolonel Cikaçit në bazë të këtij arsyetimi nuk do të çonin peshë në pranueshmërinë e ankesës.

42. Kështu, vendimi për vërejtje ndaj pranueshmërisë duket se varet nga rezultati i shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës. Paneli përkujton se në rastet kur çështja e

pranueshmërisë është ngushtë e lidhur me bazueshmërinë e ankesës, në bazë të rregullës 31*bis* otë Rregullores së tij të punës, mund t'ia bashkëngjis çështjen aspektit të bazueshmërisë, me kusht që të mos ketë pengesa të tjera për pranueshmërinë (shoh Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), *R.P.*, nr. 120/09 dhe nr. 121/09, vendimi i datës 26 nëntor 2010; PKDNj, *Morina*, nr. 36/08, vendimi i datës 16 dhjetor 2010, § 46).

43. Paneli konsideron se ankesa ngritë çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës. Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se në bazë të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 ankesa në shikim të parë nuk është e pabazuar.

44. Nuk janë konstatuar arsye të tjera për shpalljen e ankesës së të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri, ,

SHPALL TË PRANUESHME PJESËN E MBETUR TË ANKESËS.

Anila PREMTI	Paul LEMMENS
Ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive	Kryesues